



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3017/2021
Data: 21.04.2021

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e tretë -III- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 25.03.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Besiane Bushi (Kryesuese e komitetit për arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2020.
4. Raportet e punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2020.
5. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2019.
6. Kërkesë për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.
7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2020.
8. Njoftim për aktivitetet e këshillave lokale të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
9. Kërkesë e z.Ramush Krasniqi.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë rrreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- nga dita e djeshme në QKMF është duke u kryer edhe testi rapid. Për herë të parë dje janë bërë tetë teste rapide dhe prej tyre dy kanë dalur pozitiv. Gjatë muajit mars prej instituti kombëtarë të shëndetit publik të Kosovës (IKSHPK) i kemi nëntë raste. Është duke vazhduar testimi me testet serologjike.

Sabedin Hasallari thekson:- testet rapiden a bëhen në mënyrë vullnetare nga qytetarët apo me rekomandim të mjekut.

Florim Shkreta thekson:- çfarë masa merren ndaj një personi i cili shfaqet me simptome të kovidit.

Medina Imishti thekson:- testet rapide bëhen me rekomandim të mjekut. Çdo pacientë që ka shfaqur dyshime është rekomanduar për vetë izolim deri kur i është bërë testi dhe pastaj ju është rekomanduar për vetizolim. Në momentin që pacientët që kanë rezultuar pozitivi janë njoftuar edhe policia

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:-komiteti në fjalë ka planifikuar ti mbajë dymbëdhjetë mbledhje por i kanë mbajtur njëmbëdhjetë mbledhje në vitin 2020. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2020

4. Raportet e punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- komitetet konsultative kanë planifikuar që ti mbajnë nga gjashtë mbledhje. Nga katër komitetet që janë dy i kanë mbajtur nga gjashtë mbledhje dhe dy nga pesë mbledhje. Kryesuesit e komiteteve konsultative ju kemi bërë ftesë që të marrin pjesë në mbledhje të kuvendit por prezentë e kemi vetëm kryesuesen e komitetit konsultativ për arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështjen e pengesave te parkingu i QKMF-së e kemi diskutuar edhe në komitet për politik e financa dhe do të ishte mirë me najë dhënë një sqarim se nga kush është marr vendimi që janë vendosë ato pengesa, sa kanë efekt ato pengesa.

Hanumshahe Dibrani thekson:- kërkoj sqarim z.Edon Curri dhe znj.Nurane Bushi se a marrin pjesë në mbledhje të komiteteve konsultative.

Sead Vila thekson:-raporti është i zbehtë për shkak se për një vit katër komitet me ekip kanë dhënë vetëm rekomandime dhe ata shumë simbolike. Do të ishte mirë që të kenë një raport më të detajuar sepse secili komitet i ka nga pesë anëtarë dhe në raport i kanë prezantuar vetëm pesë apo gjashtë rreshta dhe mu personalisht mu dukë i zbehtë. Vërejtje kam për kryesueset e komiteteve të tjera të cilët nuk janë prezantë dhe në të ardhmen duhet të obligohen të jenë prezantë.

Teuta Shkreta thekson:- raporti i komitetit për persona me aftësi të kufizuara është i mangët sepse komiteti në fjalë ka mundësi që të paraqet kërkesa për çdo gjë që kanë nevojë. Është dashur të paraqitet një evidencë për këtë kategori në mënyrë që të dihet sa prej tyre kanë nevojë për syza, sa prej tyre kanë nevojë për proteza, sa prej tyre kanë nevojë për karroca, sa prej tyre kanë nevojë për fizioterapi. Dëshira ime është që ki komitet të funksionon sa më shumë dhe ne si asamblistë të jemi në ngjarje se çka po ndodhë me këtë komitet.

Florim Shkreta thekson:- në bazë të reportit që e ka paraqitur komiteti për persona me aftësi të kufizuara i ka kërkuar gjërat elementare të kësaj kategorie, ka kërkuar punësim, ka kërkuar me ju siguar një zyre , ka kërkuar me bërë marrëveshje me komunën për me i dhënë ndihmë nga kompanitë private pikërisht kompania "Sharrcem". Kryesuesja e këtij komiteti do të ishte mirë me qenë prezantë për me dhënë svarime edhe më shumë.

Refet Kalisi thekson:- sa i përket vendosjes së pengesave te parkingu i QKMF-së në bashkëpunim me drejtoreshën e shëndetësisë e kemi bërë për shkak të trotuarit që është mbyllur por kërkesë kam pasur edhe prej qytetarëve . Qytetarët i kanë parkuar veturat në mëngjes dhe pastaj trotuari çdo herë ka qenë i bllokuar.

Mehmet Ballazhi thekson:- ju e keni vendosur por edhe një pjesë tjetër e qytetarëve kanë kërkuar me i hequr pengesat. Unë edhe në KPF e paraqita për shkak se pata rast me shkuar në QKMF dhe realisht ishin pengesë për qytetarët për shkak se një veturë e parkuar në fillim të pengesave dhe një veturë e parkuar në fund të pengesave që do të thotë pengoheshin kalimtarët për me kaluar. Kërkesë ka nga qytetarët që ata të hiqen dhe më mirë do të ishte më bërë një zgjidhje të përhershme në monitorim të inspektoratit të komunës apo policisë që ai parking të jetë vetëm për pacientët apo për ata që i sjellin pacientët. Punëtorët e shëndetësisë më mirë do të ishte që ta kenë një parking te objekti i komunës sepse në mëngjes shkojnë në punë dhe tërë ditën janë në ambulantë , ndërsa pacientët vijnë për një kohë më të shkurtë. Duhet të bëhet një zgjidhje ose të ngushtohet ajo pjesa e hapësirës së ambulantes që me bërë një pjesë për parking dhe një pjesë për kalimtarët.

Florim Shkreta thekson:- parafolësi potencoja disa fjalë dhe do të ishte më mirë që me zgjeruar atë pjesë te pjesa e parkingu dhe me i hequr rrethojat me përcaktuar hapësirë për këmbësorë dhe me vendosë që parkingu është vetëm për pacientë për me i parkuar veturat. Ankesa ka prej qytetarëve të cilët shkojnë në QKMF për me kryer shërbime por veturën nuk kanë ku me parkuar. Është rrethuar vetëm një pjesë dhe shtrohet pyetja pse nuk është rrethuar edhe pjesa poshtë e trotuarit që do të thotë me këto rrethoja keni hasur dilema më të shumta.

Teuta Shkreta thekson:- sa i përket çështjes së rrethojës neve si personel na konvenon si ishte më herët por tash po flas në cilësinë e prindit dhe në cilësinë e një banori se pengesat janë shumë të nevojshme se për deri sa ne si qytetarë vendosim me shkuar në atë pjesë duhet ta dimë ku e kemi trotuarin. Ne nuk po e llogarisim atë pjesën tjetër po e llogarisim pacientin dhe për raste urgjente besoj që i nxënë katër vetura nëse e kemi sjellë ndonjë familjarë dhe nuk kemi pse të ankokemi. Nëse flasim për të mirën e qytetarëve është më mirë siç është vendosur.

Medina Imishti thekson:- gati se në secilën mbledhje të komitetit për persona me aftësi të kufizuar kam marr pjesë dhe nëse është një komitet që e ka realizuar planin e vetë është komiteti për persona me aftësi të kufizuara. Nuk e di sa e keni lexuar planin për me parë se çka është bërë në raport që pik e parë e planit ka qenë funksionalizimi i Hendikosit gjë që e cila është bërë. Për momentin e kemi Hendikosin që është licencuar dhe kryetari i komunës ka premtuar që do të i subvencionon me një shumë prej 1500 € dhe me ju ndihmuar në rregullimin e zyrës për të cilën janë tu pasur nevojë. Ne e kemi pasur një punëtore e cila në teren e ka bërë regjistrimin e personave me aftësi të kufizuara por kam dashur që ky komitet me bërë edhe strategjinë për persona me aftësi të kufizuara. Sa i përket rrethojës me shumë sinqeritet unë them që mos me hekur sepse kërkesa ka ardhur nga drejtoria e shëndetësisë te drejtoria për shërbime publike sepse arsyet që qenë se ajo pjesë asnjë herë nuk është shfrytëzuar prej pacientëve për shkak se në atë vend dympbëdhjetë apo trembëdhjetë punëtore shëndetësorë i kanë parkuar veturat për çdo ditë. Ju kam sugjeruar punëtoreve shëndetësorë mos me i parkuar veturat në atë vend por përsëri i kanë parkuar. Ne jemi duke menduar që me bërë zgjidhje më afat gjate për pacientët e jo në të mirë të personelit. Pacientët shumë rrallë kanë pasur vend për mi parkuar veturat për shkak se punëtorët e kanë zënë vendin dhe punëtorët duhet të mundohen pakë e përparësi të u jatin pacientëve që kanë nevojë për shërbime .

Mehmet Ballazhi thekson:- personeli i ambulantes nëse nuk është i vetëdijshëm që atë parking me lënë për pacientët atë herë është çështje inspektoratit apo e policisë por nuk është mirë të bimë në atë nivel. Nëse është në interes të qytetarëve do të ishte më e mirë zgjidhja që parkingu të jetë për pacientë për kohë të shkurtë dhe ne të monitorohet. Kërkoj që pengesat të hiqen dhe të bëhet një zgjidhje më e mirë.

Teuta Shkreta thekson:- nuk kam asgjë kundër këtij komiteti por vetëm ndihma jonë duhet të jetë në mënyrë që me i parë shqetësimet e tyre shumë më thellësisht.

Bajrush Laçi thekson:- z.Edon Curri ka dhënë dorëheqje, ndërsa znj.Nurane Bushi nuk ka dhënë por ka të drejtë të jetë edhe anëtarë e komitetit.

Kryesuesi thekson:- edhe në KPF e kam diskutuar alternativa ka dhe nuk do të thotë që është marr një vendime nuk kthehet por alternativa ka dhe është mirë që me u zgjeruar ajo pjesë, kështu që me u shqyrtuar edhe një herë është mirë. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KATËR KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2020

5. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- vitin që shkojë kemi pasur raportin e auditimit dhe nga ai raport kemi pasur shtatë rekomandime dhe nga ky raport pesë rekomandime janë zbatuar plotësisht, ndërsa dy rekomandime janë pjesërisht. Nëse keni ndonjë vërejte apo sugjerim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- në raportin e rekomandimit të auditorit po ndodhë që po përsëritet dy herë i njëjtë rekomandim. Regjistrimi i gjendjes faktike të komunës bëhet fjalë për pasurinë e patundshme që kam parashtruar një pyetje dhe përgjigjja më është dhënë se është bërë regjistrimi që komisioni i brendshëm i komunës e ka bërë por mu nuk më ka interesuar kjo, por pyetjen e kam parashtruar se a është bërë regjistrimi i gjendjes së pasurisë dhe tash me sa e kuptojë unë i njëjtë rekomandim është përsëritur dhe potencon që nuk është bërë regjistrimi i pasurisë së patundshme.

Kryesuesi thekson:- rekomandimet të cilat nuk plotësohen përsëriten deri sa të plotësohen.

Mehmet Ballazhi thekson:- te rekomandimet pjesërisht të zbatuara vërejtje kemi dhënë që së paku mos të shkruhen pjesërisht të zbatuara sepse nuk është e zbatuar ajo. Te rekomandimi i gjashtë dobësi në procesin e prokurimit rekomandimi është bërë diçka tjeter nga ajo që ju e keni shënuar pjesërisht e zbatuar dhe çdo herë kemi potencuar për projektet sepse asnje herë nuk po specifikohen. Mjetet rezervë që duhet të përcillen nëpër kategoritë e tjera buxhetore por nuk ka specifikim të projekteve e janë marr në bazë të paramasave dhe parallogarite por këtu kërkohet specifikim i projekteve.

Shabi Rexhallari thekson:- rekomandimi numër shtatë te pasuritë kapitale dhe jo kapitale ka të bëjë me pasuritë mbi njëmijë euro dhe nën njëmijë euro ashtu siç e specifikon rregullorja 2013 e Ministrisë së Financave. Te regjistrimi i pasurisë mbi njëmijë euro të gjitha i kemi të regjistruar ashtu siç potencon rregullorja, ndërsa te pasuria që është nën njëmijë euro që hyjnë pajisjet qoftë mobilet, kërrigat, kompjuterë, llaptopë dhe çdo pajisje nën një mijë euro ende nuk ka përfunduar ky proces. Pengesë është sistemi i epasurisë që këtë problem e kanë gjitha komunat se ka qenë sistem i vjetër dhe është bërë integrimi me një sistem të rije dhe pjesa që ka qenë më herët e regjistruar në sistemin e vjetër kur është bërë integrimi në tërsi nuk i ka qitë pajisjet siç i kemi pasur ne. Shkollat e kanë bërë regjistrimin dhe zyrtari i depos nuk mund me i futë në sistem pa i bërë ministria përmirësimet. Në momentin që do ta bënë ministria përmirësimin depoisti do të fillon me ua vendosur barkodet dhe me i regjistruar në sistem pastaj prej atij momenti fillon edhe zhvlerësimi i pasurisë. Sa i përket vërejtjes te projektet ka rekomanduar që mos me u shpallur tenderë pa u bërë hartimi i projekteve. për projekte madhore kemi bërë projekt ndërsa për projekte të kupëzmit të rrugëve kemi shkuar me parallogarit dhe paramasë. Pjesërisht është shënuar për shkak se kemi bërë diçka për shkak se i kemi paramasat për projektet e vogla por edhe projektet e vogla secilin projekt e kemi dërguar me parallogarit dhe paramasë.

Sabedin Hasallari thekson:- kush është përgjegjës për ndryshimin e faturave të tatimit në pronë për shkak se po kemi probleme me faturat e tatimit në pronë .

Shabi Rexhallari thekson:-përgatitjen e faturave e bënë Ministria e Financave, komuna i merr me cede dhe e bënë printimin dhe asnje të dhënë nuk mund ta ndryshojmë.

Rufki Suma thekson:- rregullorja është miratuar e cila i përcakton katër këshilla, mirëpo për shkak të pandemisë nuk kemi mundur me i mbajtur takimet dhe me bërë përzgjedhjen sipas rregullores. Sa i përket telefonave kontrata ka skaduar qysh në vitin e kaluar dhe kemi dashur me hapur tender ~~q~~ nuk na kanë lejuar dhe kanë potencuar që duhet me pritur nivelin qendrorë sepse vetëm ministria mundet me bërë kontrata. Kohët e fundit ka pasur probleme me rrymë në fshatin Krivenik për shkak reshjeve të borës. Çështja e rrymës është obligim i KEDS-it e jo i komunës por unë kontakte kam pasur që me reaguar më shpejtë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. Kërkesë për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- rezerva ka ardhur për shkak se Ministria e Financave i ka miratuar dy udhëzime dhe kur është bërë futja e të dhënavë të projekteve sikur herave të tjera kanë ndodhë disa kritere të tjera dhe në tridhjetë komuna një pjesë e mjeteve ka kaluar në rezervë që ka të bëjë të projektet kapitale. Janë katër projekte të cilat kanë kaluar në rezervë dhe sipas ligjit të buxhetit duhet të miratohen në kuvend. Për vitin 2021 në shumë prej 55,000.00 €, në shumë prej 160,000.00 € për vitin 2022, si dhe në shumë prej 270,375.00 € për vitin 2023 nga fondet 10, 21, sipas nën-programeve buxhetore dhe projekteve kapitale. Shtrimi me kubëza betoni nëpër zonat urbane dhe rurale të Hanit të Elezit që në këtë rast na kanë kërkuar që ti cekim edhe emrat e rrugëve që më herët nuk është kërkuar. Rregullimi i kanalizimeve nëpër zonat urbane dhe rurale të Hanit të Elezit që janë të përcaktuara edhe rrugët. Rregullimi i shtigjeve për këmbësor dhe çiklistë përgjatë lumit Lepenc (Uji i thartë - Kulla me çeshme) që ka të bëjë me vitin 2022-2023 dhe projektet në arsim që ka të bëjë me riparimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në fshatin Pustenik.

Mehmet Ballazhi thekson:- ishte bërë një hapë përpara me përcaktimin e emrave të projekteve dhe më interesoj rruga "Izet Bushi" është e pa shtruar ende dhe nuk ka tabelë. Kur kemi diskutuar me drejtorinë e shërbimeve publike kemi diskutuar për me shtruar me asfalt , ndërsa në këtë kërkesë është për me i bartur mjetet për kubëza betoni, a mundë të ndryshohet si projekt apo jo. A bëhet fjalë vetëm me i bartur mjetet apo do të kryhet si projekt sepse edhe vitin e kaluar janë bartur mjetet dhe janë alokuar mjetet aty ku ka qenë interesi politik apo gruropë, ndërsa tjerat janë bartur për vitet e ardhshme. Kërkesa që ka qenë prej viti 2017 as nuk është marr parasysh me u bërë ai projekt. Është paraparë me u shtruar me kupëza betoni dhe a mund të ndryshohet që ajo rrugë me u bërë me asfalt. Kërkesa ka qenë edhe për kanalizimin në fshatin Pustenik është shënuar diçka për kanalizimet por nuk e di a është në mënyrë specifike ajo pjesë për shkak se për vitin 2021 janë planifikuar 20 000 € dhe nuk e di a ka mundësi me u rregulluar me këto mjete.

Sabedin Hasallari thekson:-mjetet financiare rezervë a janë në arkën e komunës që duhet me u bartur apo këta projekte janë kryer apo vetëm janë projeksione.

Sead Vila thekson:- kërkoj sqarim te emërtimi i projektit riparimi i objekteve të trashëgimisë kulturore për sa objekte bëhet fjalë dhe cilët janë ato objekte

Shabi Rexhallari thekson:- janë vetëm projekte. Vitin e kaluar i kemi miratuar në këtë formë por nuk kanë qenë të specifikuara emrat e rrugëve dhe përsëri duhet t'i bartim. Krahas kategorive të tjera që janë përcaktuar me buxhet tashështë shtuar edhe kategoria rezervë dhe eshtë vetëm nga investimet kapitale. Na eshtë dhënë mundësia që ato projekte të cilat i kemi pasur me ato emërtime por me specifika të tjera që janë specifikuar emrat e rrugëve të cilat mi ka dërguar drejtoria e urbanizmit dhe i kam specifikuar që këto rrugë kanë me u shtruar brenda tri viteve por do të varet prej mjeteve financiare që do ti kemi për me i realizuar. Si numër nuk e kam se sa objekte janë të trashëgimisë.

Rufki Suma thekson:- sa i përket objekteve të trashëgimisë kulturorë në Han të Elezit e kemi një listë që janë mbi dhjetë objekte dhe shtëpitë në fshatin Pustenik , Lagja Brava, Lagja Daci por ka edhe shtëpi në Dermjak. Si kod e kemi shtijë për shkak se jemi na fazën e aplikimit me IPA fondet në kuadër të projekteve ndërkufitare ndërshtetëre. Projekti i kupëzave dhe analizimit eshtë projekt tre vjeçar dhe në shumën prej 20 000 € mundemi me shtruar një rrugicë apo dy rrugica por për shkak se eshtë tre vjeçar i kemi përfshirë edhe emrat e rrugëve dhe në fshatin Pustenik eshtë rruga “Epopeja e UÇK-së që i përfshin gati se krejt nëse bëhen pronat publike, mirëpo se sa mundemi me i kryer varet prej buxhetit. Nëse nuk kemi problem me çështjet pronësorë në këtë vit kanalizimin mund ta rregullojmë të paktën me zhvendosë prej lagjes.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë i kuptojë planifikimet që janë për tri vite por si i keni ndarë prioritet e shtrimit të rrugës me kupëza betoni dhe për kanalizimin. Me këto mjete që i keni paraparë cili do të jetë prioritet pra si do të janë kriteret. Për çështjen e rrugës kemi diskutuar për me u bërë me asfalt dhe si e ndërroni ju me shtruar me kupëza betoni a ka ndonjë problem. Çdo herë ne po alokojmë mjete, po ndryshojmë planifikime , projeksione që do të thotë eshtë një mënyrë teorike dhe një lloj demagogjie. Prej në fillim e mbaj mend kur ishte prioritet uji u planifikofshin nga 10 000 € vetëm sa me nxan kodin buxhetor dhe u theksojke se çështja e ujit eshtë prioritet mbi prioritetet dhe u harrua kjo punë e çështja e ujit nuk u zgjidhë asnjë herë dhe tash as si prioritet nuk del. Nga viti 2021 ka kërkesë për rregullimin e këtyre rrugëve dhe rrugicave dhe as që eshtë bërë fjalë kjo. As për kanalizimin nuk eshtë bërë fjalë dhe gjithmonë njeriu e gjanë një arsy për mos me zgjidhur një problem.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 9 për, 2 abstenim (nga grapi parlamentarë i PDK-së)

U MIRATUA KËRKESA PËR TRANSFERIN E MJETEVE NGA KATEGORIA EKONOMIKE REZERVA NË SHPENZIME KAPITALE

7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- me udhëzim administrativ jemi të obliguar që ta njoftojmë kuvendin. Të gjitha çështjet të cilat janë diskutuar i kemi shënuar dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sabrije Krasniçi thekson:-çështja e fëmijëve të cilët rrinë te kufiri nuk eshtë diskutuar edhe pse më herët eshtë përfolur. Para dy apo tri dite patrulla e policisë qëndrojke te kufiri dhe fëmijët qëndronin fshehurazi duke i pritur se kur po shkojnë. Edhe me prindërit e di që nuk mund te merren veshë dhe fëmijët nuk po kuptojnë por nuk duhet të lihet anash kjo çështje dhe duhet të gjendet zgjidhje. Rruga te kufiri që shkon në drejtim të fshatit Seçishtë dhe nëpër fshatrat tjerë po bllokohet dhe eshtë mirë me qëndruar patrulla e policisë për shkak se po e bllokojnë rrugën. Eshtë diskutuar çështja e qenve endacak por te kufiri dhe te pjesa e rrugës që eshtë ka Ura e Seçishtës ka shumë qenë endacak . Çka mendohet të bëhet me çështjen e qenve endacak.

Florim Shkreta thekson:-çështjet janë diskutuar po sa janë duke u realizuar çështjet. Çka eshtë bërë me rastin e punëtorit i cili e ka humbur jetën në kompaninë “Sharrcem”. Eshtë diskutuar çështja për mjetet financiare fall që janë zënë dhe çka eshtë bërë më tutje. Për çështjen e ambientit a keni ndërmarr ndonjë hap më tutje.

Sabedin Hasallari thekson:- rastin e punëtorit i cili e ka humbur jetën në kompaninë “Sharrcem” kush e ka ngritur si çështje dhe në vitin 2019 kemi pas humbje të një qytetari të komunës sonë dhe në informatën e viti 2019 nuk eshtë cekur.

Rufki Suma thekson:- çështjet të cilat diskutohen në KKSBB nëse shënohen të gjitha bëhet një informatë me qindra faqe por ne i kemi përmendur si aktivitet dhe çështje që bisedohen. Policia raporton me shkrim për çdo aktivitet se çka ndodhë për çështjet të cilat janë në kompetencë të stacionit policorë. Ka raste kur konfiskohen substanca narkotike dhe dikush mund të potencon që nuk është përmendur por realisht përmendet në takim por është kompetencë e njësitet tjetër që është anti drogë që është nivel qendrorë. Mund të ndodhë ndonjë vrasje por është kompetencë e njësitet për krimet e rënda, ndërsa policia raporton si rast që është në kompetencë të policisë. Çështja e qenve endacak e kemi biseduar çdo herë por nuk kemi mundur me ndërmarr asgjë se përsipër e ka marr AVUK-u në tërë territorin e Kosovës dhe ne nuk kemi asnje informatë që ka ndonjë trajtim tek ne. Është diskutuar edhe çështje e personave që janë zënë me mjete financiare fallc por është çështje e policisë me vazhduar procedurën më tutje. Te rasti i punëtorit i cili e ka humbur jetën në kompaninë “Sharrcem” është raportuar si rast për ndryshe në çdo takim rapportohen çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë. Rasti te kufiri që u përmend për çdo mbledhje diskutohet dhe është qendra për punë sociale që në bashkëpunim me policinë merret me këtë çështje dhe ka raste që janë shqiptuar gjoba. Për çdo mbledhje diskutohet çështja e bllokadës së rrugës që shkon në drejtim të fshatit Seçishtë dhe në disa fshatrave të komunës dhe kemi kërkuar edhe nga polica kufitare me ndërhy por ata e njoftojnë policinë e stacionit. Gjitha çështjet që bisedohen dhe që janë në kompetencë të komunës komuna mundohet me kryer ndërsa për çështjet të cilat nuk janë në kompetencë të komunës i jepim vërejtje tona si komunë.

Mehmet Ballazhi thekson:- për çështjet të cilat janë diskutuar a është bërë zgjidhje sepse ne mund të diskutojmë. Është diskutuar çështja e realizimit të projektit në rrugën Hani i Elezit – Gorancë. Pengesa të bëhen te kufiri ne jemi të përditshëm në atë pjesë a është bërë ndonjë zgjidhje.

Florim Shkreta thekson:- në pikat që nuk ka mundësi komuna me ndërhyrë ose me kontribuar do të ishte e mirë që të paktën mos me paraqitë në këtë informatë. Te realizimi i projektit në rrugën e fshatit Gorancë keni pasur punë pak më herët të hudhja e dheut sepse këtu është rreziku dhe është dashur me marr më seriozisht. Është diskutuar për themelimin e një këshilli për parandalimin e koronavirusit por është mirë me marr ma seriozisht këtë çështje për shkak se kohët e fundit po rritet edhe numri i rasteve.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhë të paraparë sipas agjendës.

8. Njoftim për aktivitetet e këshillave lokale të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Edon Curri thekson:- këshillave lokale ju ka përfunduar mandati në muajin prill të vitit 2020 dhe për shkak të pandemisë nuk kemi mundur me bërë përzgjedhjen. Në bazë të rregullores për bashkëpunimi me këshillat lokale parashihet që të jenë vetëm katër këshilla lokale. Përzgjedhjen e këshillave lokale nuk kemi mundur me bërë për shkak të pandemisë dhe në momentin që do të bëhet lehtësimi i masave apo kalimi i pandemisë do të bëhet përzgjedhja e këshillave lokale të fshatrave. Përveç këtij materiali diçka të veçantë nuk kam .

Florim Shkreta thekson:- si do të shkon procedura që do të mbesin vetëm katër këshilla të fshatrave.

Mefail Suma thekson:- e lexova shkresën që është dhënë nga drejtoria për administratë dhe po më duket pak e pa bazë për shkak se për deri sa të gjitha institucionet punojnë dhe veprojnë në pandemi edhe këshillat e fshatrave kanë mundur me i kryer punët e veta. Faji nuk është i këshillave të fshatrave sepse ata nuk bëjnë vetë organizim por faji është i ekzekutivit që nuk i ka njoftuar dhe nuk kanë vazhduar. Kuvendi po mbanë mbledhje edhe këto më shumë nuk munden me u bërë për me mbajtur një takim. Duke u mbështetur edhe në raportet e punës së mëhershme unë mendoj që më shumë kanë punuar tash këshillat e fshatrave edhe pse janë pa mandat se sa më herët. Rregulloren për këshillat e fshatrave e kemi miratuar dhe është mirë të zbatohet e mos të neglizhohet.

Teuta Shkreta thekson:- çështja e rrymës është duke paraqitur problem se kohët e fundit po ndalet shumë dhe është mirë komuna me biseduar për përgjegjësit për këtë çështje. Punëtorët e QKMF-së që kanë qenë me shoqatën “Islamik Relief” a egzistonë mundësia që të ju paguhen mëditje. Kërkoj sqarim për çështjen e telefonave që ishin me kontratë për shkak se po ndërprenhet.

Medina Imishti thekson:-kontrata ka skaduar me shoqatën “Islamik Relief” që e kemi pasur dhe jemi tu pritur për kontratën e re dhe punëtorët nuk i kemi detyruar as nuk i kemi obliguar me nejtë në QKMF por kanë pranuar që me kontribuar si vullnetarë , kështu që drejtoria nuk ka kod buxhetorë dhe nuk ka mundësi buxhetore për me i paguar vullnetarët të cilët vijnë në QKMF.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhë të paraparë sipas agjendës.

9. Kërkesë e z.Ramush Krasniqi.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:-materialin e keni pranuar me kohë dhe kërkesa ka qenë në vitin që shkojë dhe ju kemi përgjigjur që nuk mund të japid pëlqim për shkak se është duke u përgatitur plani zhvillimore komunal dhe me atë plan do të përcaktohen se cilat do të janë zona të turizmit dhe cilat nuk do të janë. Parashtruesi i kërkesës ka insistuar dy apo tri herë dhe vendimin e merr agjensioni i pyjeve për shkak se është pronar i pronës, ndërsa prej komunës kërkohet një pëlqim paraprakë. Ne kemi diskutuar me agjensionin e pylltarisë dhe ata kanë sugjeruar që të shkohet përmes kuvendit të komunës. Komisioni i komunës ka dalur në vend të ngjarjes dhe ka përgatitur raportin të cilin ju e keni. Jemi tu insistuar që në të dy zonat e pishave që kanë me u bërë pra në Gorancë dhe Neqafçë me u përcaktuar se ku kanë të drejtë me u ndërtuar dhe ku nuk kanë të drejtë me u ndërtuar. Vardin të cilin e ka kërkuar parashtruesi i kërkesës nuk pengon dhe në momentin që do të ipet leja nga drejtoria e urbanizmit do të ju përcaktohen kushtet për ndërtimin e objektit.

Sead Vila thekson:- me datë dy qershori ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe ju është kthyer vendim që i refuzohet kërkesa për ndërtimin e shtallës, ndërsa në kërkesën që e ka parashtruar në kuvendë bëhet fjalë për një veprimtari biznisore . A është fjalë që ka ndërruar destinimi i veprimtarisë ekonomike se çka ka dashur me bërë. Personalisht nuk jam kundër sepse është në interes edhe të komunës edhe të palës dhe duhet të ju ipet hapësirë në mënyrë që të zhvillohet ekonomia.

Hanumshahe Dibrani thekson:- a ka me paguar ndonjë përqindje të qirasë dhe a është përcaktuar se për sa vite e merr në shfrytëzim atë pjesë.

Rufki Suma thekson:- kërkesa është paraqitur për restorant por e di që ai është interesuar edhe për shtallë por qëndrimi i komunës është mos me lejuar ndërtime të shtallave në hapësirat turistike brendi të pishave. Ndoshta kërkesën e kanë paraqitur në ministri për shtallë duke menduar se taksa do të jetë më e lirë. Taks nuk i paguan komunës por Ministrisë së Bujqësisë , ndërsa komunës i paguan takse për ushtrim të veprimtarisë.

Sabedin Hasallari thekson:- për sa kohë do ta merr në shfrytëzim pronën, a ka ndonjë afat të caktuar apo është sikur shitjet që janë bërë përmes AKP-së

Rufki Suma thekson:- e marrin hapësirën në shfrytëzim dhe ministria ja përcakton se për sa vite sepse llogariten objekte të përkohshme , kurse komuna jep vetëm pëlqim. Parashtruesi i ka kërkuar tridhjetë ari ndërsa komisioni ka dal në teren dhe ka rekomanduar që ti epen dymbëdhjetë ari.

Mehmet Ballazhi thekson:- me sa kam informata pëlqimet që ipen nëse brenda dy viteve nuk e realizon qëllim e projektit atëherë i merret pëlqimi.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E Z.RAMUSH KRASNIQI

3. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Samire Curri thekson:-në mbledhje të komitetit për komitete jemi njoftuar nga kryetari i KVRL-së për aktivitetet dhe propozoj që brenda komunës apo shtëpisë së kulturës të ketë një zyre KVRL-ja ku mund të adresohen të rintjtë . Të vendosen dy tabela orientuese njëra në fshatin Paldenicë , në fshatin Dermjak dhe njëra për te pishat.

Mehmet Ballazhi thekson:- anksesa ka nga banorët e fshatit Gorancë për çështjen e rrugës së Gorancës të cilët kërkojnë nga komuna që të ushtron ndikim te kompania që punimet me u kryer më shpejtë. Qytetarët kërkojnë që rruga e vjetër të shtrohet në mënyrë që të bëhet zgjidhje e përkohshme sepse është problem me kaluar në atë pjesë.

Kryesuesi thekson:- konsulta kam pas me kryetarin e këshillit të fshatit Gorancë por problemi është se kompania i ka 200 ditë pune dhe askush nuk e dinë se a llogaritet dita e shtunë dhe e diel, pastaj në marrëveshje e kishin të përcaktuar se nëse koha nuk mbanë nuk llogariten ditët dhe këtë 200 ditshin mund ta qojnë edhe dy vite apo tri dhe është problem. Projekti është i Ministrisë dhe kam këruar nga kryetari i këshillit të fshatit Gorancë që edhe ata me ushtruar presion të kompania që me i kryer punimet sa më shpejtë për shkak se me një far mënyre me atë rrugë ai fshatë po izolohet.

Mehmet Ballazhi thekson:- projekti është i ministrisë por qytetarët janë të komunës sonë dhe duhet gjinden mënyra se si me i bërë presion që të bëhen zgjidhje për qytetarët.

Rufki Suma thekson:- autostrada kur është bërë vetëm e ka shpallur njoftimin për çështje të punimeve dhe as që na ka treguar se ka me shkuar dhe nuk është bërë problem se sa është bërë problem çështja e rrugës së Gorancës dhe para se me filluar kjo rrugë është riparuar rruga e vjetër, është riparuar rruga Gorancë-Krivenik, rruga Pustenik –Rzhancë, rruga e Hasallarve që do të thotë janë bërë katër rrugë alternative. Është e vërtet që kur të punohet bllokohet rruga dhe projekti është dy vjeçar por edhe pse nuk është projekt i komunës jemi të interesuar sepse është tu bërë për ne. Kompanisë vetëm 150 000 € ja kanë kompensuar për kryerjen e atyre punimeve dhe për vitin 2021 janë ndarë mjete për atë projekt dhe nuk janë më shumë se 250 000 € dhe realisht edhe na me qenë pronarë të kompanisë kemi me potencuar që punojmë për ato mjete që janë të planifikuara , mirëpo neve nuk na intereson kjo çështje por na intereson punët me u kryer më shpejtë. Gjatë sezonës së dimrit që ka pasur rrëshqitje të dheut edhe kompaninë e kemi thirr por edhe komuna ka dal dhe disa herë kanë shtruar zhavorr dhe e kanë mirëmbajtur dhe riparuar. Në bazë të bisedave që i kemi pasur vitin që shkojë me mbajt rrugën e bllokuar, ndërsa në vitin 2021 mos me bllokuar rrugën por me punuar me kujdestari me pasur punëtorë në rrugë dhe me qarkulluar rruga poshtë.

Florim Shkreta thekson:- kërkoj sqarim për konkursin që ka qenë kohët e fundit a është anuluar apo ku qëndron problemi


Rufki Suma thekson:- konkursi është anuluar për shkak të procedurave që parashihen në ligj të ri për shkak se është paraparë që intervistimet me u bërë në mënyrë elektronik dhe me qenë një kabinet. Fillimi i kanë paraparë me qenë një kabinet në Prishtine me pesëmbëdhjetë kompjuterë për me hyjë kandidatët në provim për krejt konkurset që dalin në nivel të Kosovës që realisht në bazë të planit që e kanë për dy apo tri vite komuna nuk mund t'i kryen konkurset dhe niveli qendrorë. Kushti ka qenë me bërë konkursin e brendshëm, pastaj me shpall konkurs të jashtëm. Komuna e ka përfunduar konkursin e brendshëm dhe kemi dashur me shpall konkursin e jashtëm na kanë njoftuar që nuk keni drejtë me shpallë konkurs për shkak se ende qeveria nuk është e gatshme me zbatuar ligjin e ri në formë elektronike. Kërkesa për zyre kemi pasur vazhdimisht nga shoqata dhe organizata të ndryshme dhe do të shikohen mundësitet çështja e zyrës për KVRL-në. Për momentin KVRL-ja për aktivitet të ndryshme e ka sallën e takimeve në komunë që mundet me shfrytëzuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:52.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava